



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Teknologji bërthamë

Varianti A

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	C	A	A	B	C	C	C	D	C	B

• *Pyetjet me zhvillim*

Pyetja 11 3 pikë

Përgjigje:

- Përcaktojmë problemin, i cili është:
 - Shterimi i rezervave të vendburimeve metalore.
- Mbledhim informacion dhe parashikojmë zgjidhjet e mundshme, si më poshtë:
 - Përdorimi me kriter i rezervave ekzistuese;
 - Përmirësimi i teknologjive ekzistuese të pasurimit të metaleve, për një shfrytëzim më të mirë të rezervave të nxjerra nga nëntoka.
 - Riciklimi i metaleve të përdorura, që i gjejmë tek: varrezat e makinave, grumbullimet e metaleve të hedhura si: "skrap".
- Përzgjedhja e zgjidhjes optimale (më të mirë).
 - Riciklimi i metaleve që i gjejmë tek: varrezat e makinave, grumbullimi i metaleve të hedhura, si: "skrap".
- Realizimi i zgjidhjes optimale (të përzgjedhur).
 - me sistem teknologjik, ku, qëllimi është: "Riciklimi i metaleve"
- Vlerësime dhe korrigjime mbi zgjidhjen e problemit.

Pyetja 12
Përgjigje:

3 pikë

<i>Vetitë fizike</i>	<i>Vetitë mekanike</i>	<i>Vetitë teknologjike</i>
<i>ngjyra, shkelqimi</i>	<i>fortesia, elasticiteti</i>	<i>petëzueshmeria</i>
<i>gjendja fizike, dendesia</i>	<i>qëndr. në shtypje</i>	<i>telëzueshmeria</i>
<i>temp. e shkrirjes</i>	<i>qëndr. në goditje</i>	<i>farkëtueshmeria</i>
<i>percjellshm. elektrike.</i>	<i>thyeshmeria, plasticiteti</i>	<i>prerja, shformimi, etj</i>

Pyetja 13


Përgjigje

- a) Metalet me ngjyra perdoren: **2 pikë**
 Au, Ag dhe Pt kryesisht per bizhuteri dhe per veshjen e metaleve te tjera.
 Al. perdoret per pjese te automobilave, avioneve, anijeve dhe per ene kuzhine;
 Cu perdoret per percjellës elektrik, fletë, tuba, zbukurime dhe enë kuzhine;
 Ni dhe Zn perdoren per veshjen e metaleve te tjera me shtresë antikorrozive, etj.
- b) Lidhjet që krijon Fe me C janë: **1 pikë**
- Çeliku që përmban: 0.1 - 2.14 % C dhe
 - Giza që përmban: 2.14 – 6.67 % C

Pyetja 14

Përgjigje


- a) Ky mekanizëm përdoret tek MDB (boshti me gunga) dhe shërben për hapjen dhe mbylljen e valvolave të cilindrave (të motorrit). **1 pikë**
- b) Fig. Paraqitja skematike e mekanizmit me gunge. **2 pikë**



Pyetja 15


Përgjigje

- a) Lidhja me shliza bën pjesë tek lidhjet e zbrërthyeshme të detaleve. **1 pikë**
- b) E krahasuar me lidhjen me percina ka këto avantazhe: **2 pikë**
- Është praktike në përdorim;
 - Përdoret për një kohë më të gjatë përdorimi;
 - Zbrërthehet dhe mbërthehet lehtësisht;
 - Ka kosto më të ulët se lidhja me percina.


Pyetja 16**2 pikë****Pyetja 17****3 pikë****Përgjigje.**

Efektet negative që ka krijuar teknologjia janë:

- Degradimi i mjedisit;
- Ndotja e mjedisit;
- Shterimi i rezervave të burimeve natyrore;
- Pakësim i kënaqësisë nga puna;
- Rrezikimi për një jetë të plogësht.
- Shtimi i rradhëve të papunësisë.

Pyetja 18**3 pikë****Përgjigje:****Pyetja 19**

- | | |
|--|---------------|
| a) Ndërtimi i pamjes në horizontal. | 1 pikë |
| b) Ndërtimi i pamjes në vertikal.. | 1 pikë |
| c) Realizimi i prerjes me rrafshin prerës (si në figurë), duke ndjekur rregullat për vijëzimet dhe emërtimin e prerjes. | 2 pikë |



Pyetja 20

3 pikë

